REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik/Municipality of Kaçanik

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

I	Data 04.02.2026	Vendi KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë
09	104/02-3112	-/-

Kaçanik,04/02/2026

Duke u bazuar në Vendimin e Kryetarit të Komunës së Kaçanikut Nr. **01-104/02-2049/26**, datë **23.01.2026,** në Rregulloren **MF-NR-04/2017** mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe në Rregulloren Komunale nr. **06/2016** për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve, Komuna e Kaçanikut, përkatësisht **Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**, shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për mbështetje financiare të projekteve/programeve të OJQ-ve në fushën e Kulturës për vitin 2026

1. Qëllimi i thirrjes

Komuna e Kaçanikut / Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit i fton të gjitha **organizatat joqeveritare (OJQ)** të regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në Komunën e Kaçanikut dhe kanë program pune të fokusuar në **fushën e Kulturës**, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet e tyre sipas kësaj thirrjeje publike.

2. Fushat prioritare

OJQ-të mund të aplikojnë me projekte/programe që kontribuojnë në promovimin e Kulturës.

3. Aktivitetet e mbështetura

OJQ-të mund të aplikojnë me projekte që kontribuojnë në promovimin e Kulturës përmes aktiviteteve si më poshtë:

- **NË FUSHËN E KULTURËS**

- *Promovimi dhe afirmimi i vlerave kulturore*
- *Promovimi i krijimtarisë lokale artistike*
- *Promovimi i trashëgimisë kulturore*
- *Festivalet, koncertet, shënimet e datave historike kulturore, simpoziumet dhe ekspozitat*
- *Përkrahja për grupet/shoqëritë kulturo-artistike dhe OJQ-të që funksionojnë në komunën e Kaçanikut, të cilat do të mbështeten, bazuar në realizimin e suksesshëm të programeve të tyre kulturore dhe artistike në vitet paraprake dhe planprogramit të tyre të punës për vitin 2026*
- *Përkrahje për OJQ-të duke u bazuar në planprogramin e DKRS për vitin 2026 në aktivitetet si : Organizimi i Festivalit të Këngës Popullore për Fëmijë " Kaçaniku Këndon ", Organizimi i Festivalit Kombëtar të SHKA-ve dhe Ansambleve Kulturo-Artistike, Organizimi i Aktivitetit për mërgimtarë "Ju jeni pjesë e Atdheut", Aktivitetete kulturore për shënimin e datave të rëndësishme në komunën tonë etj...*

4. Vlera totale e planifikuar e thirrjes publike në fushën e Kulturës, është **28,000.00 euro.**

4.1 Kulturë, 28,000.00 €

4.1.1 Aktivitetet Sipas Planprogramit të DKRS

4.1.2 *Organizimi i Festivalit të Këngës Popullore për Fëmijë " Kaçaniku Këndon "*

Përfituesi për organizimin e festivalit do të kujdeset që :

- *Festivali të jetë 2 ditor*
- *Të sigurohet hapsira e mbajtjes së Festivalit*
- *Të kujdeset për organizimin e festivalit me moderim, fotograf professional*
- *Të rregullohet skena dhe baneri (pano) me mbishkrim*
- *Të sigurohen minimum deri në 30 fëmijë që do të performojnë në festival në bashkëpunim me shkollat*
- *Të sigurohet teknika e ndriqimit dhe zërimit*
- *Të sigurohet restauranti për ushqim për pjesëmarrësit dhe mysafirët*
- *Të përgatiten dhe të shpërndahen ftesat dhe njoftimet me kohë*
- *Të sigurohen çmimet e festivalit (precizohen në projekt)*
- *Të sigurohet juria e festivalit.*

4.1.3 *Organizimi i Aktivitetit për mërgimtarë "Ju jeni pjesë e Atdheut"*

Përfituesi për organizimin e këtij aktivitetit do të kujdeset që :

- *Të sigurohet hapsira për mbajtjen e programit kryesor/sheshi i qytetit*
- *Të kujdeset për organizimin e aktivitetit me moderim, fotograf professional*
- *Të rregullohet skena*
- *Të bëhen njoftimet,ftesat dhe shpërndarja e tyre me kohë*
- *Të sigurohet program kulturo-artistik nga gjitha zhanret e muzikës dhe të ftohen të gjitha SHKA-të, dhe gjitha Rok –grupet kaçanikase për performim.*
- *Të sigurohet një këngëtar i estradës kosovare.*

4.1.4 *Organizimi i Festivalit Kombëtar të SHKA-ve dhe Ansambleve Kulturo-Artistike*

Përfituesi për organizimin e festivalit do të kujdeset që :

- *Festivali të jetë 2 ditor*
- *Të sigurohet hapsira e mbajtjes së Festivalit/ Sheshi i Qytetit (varësisht nga kushtet klimatike)*
- *Të rregullohet skena duke u bazuar në kushtet sa më moderne*
- *Të kujdeset për organizimin e festivalit me moderim, fotograf professional*
- *Të bëhet defilimi i SHKA-ve në Bulevardin " Ismail Raka "*
- *Të sigurohen 8 SHKA nga mbrenda dhe jashtë Kosove(Kosovë,SHqipëri,Maqedoni,Lugina e Preshevës dhe nga Mali I Zi)*
- *Të sigurohet teknika e ndriqimit dhe zërimit*
- *Të sigurohet restauranti(hoteli) për akomodim(1 natë fjetje, për pjesëmarrësit nga jashtë nëse ka) dhe ushqim të SHKA-ve musafire*
- *Të përgatiten dhe të shpërndahen ftesat dhe njoftimet me kohë*
- *Të sigurohen qmimet e festivalit të cilat duhet të jenë të denja për rëndësinë e festivalit*
- *Të sigurohet juria e festivalit*
- *Të performojnë me nga një pikë gjitha SHKA-të vendase (jashtë konkurencës së garës)*

5. Buxheti i thirrjes për Kulturë

Vlera totale e planifikuar e thirrjes publike është **28,000.00 €**

5.1 Kulturë

Mbështetje në realizimin e aktiviteteve kulturore sipas planprogramit të DKRS për vitin 2026, i cili përfshinë aktivitete në organizimin :

- 11 Qershori – Dita e Çlirimit të Kaçanikut;
- Festave të Nëntorit;
- 10 Gushti – Dita e Dëshmorëve.
- Dita ndërkombëtare e Tokës
- Dita ndërkombëtare e Librit
- Dita ndërkombëtare e muzeve
- Dita ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore
- 7 Shtatori – Kushtetuta e Kaçanikut

5.1.2 Përkrahja për OJQ-të kulturore për organizimin e aktiviteteve kulturore sipas planprogramit të DKRS për vitin 2026, përfshin subvencionimin e:

- Shpenzimet e transportit, dhe ushqimit;
- Pajisje dhe rekuizita për organizimin e aktiviteteve kulturore;
- Shpenzime të tjera të drejtpërdrejta që lidhen me aktivitetet kulturore.

5.1.3 Promovimi dhe afirmimi i vlerave kulturore
Ky objektiv synon ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e identitetit kulturor të komunës së Kaçanikut, duke nxitur vlerat tradicionale, shpirtërore dhe shoqërore që përbëjnë trashëgiminë tonë kulturore. Përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore, synohet ndërgjegjësimi i qytetarëve, veçanërisht i gjeneratave të reja, për rëndësinë e këtyre vlerave.

5.1.4 Promovimi i krijimtarisë lokale artistike
Ky objektiv ka për qëllim mbështetjen dhe afirmimin e artistëve lokalë në fusha të ndryshme si muzika, arti figurativ, letërsia, teatri dhe vallëzimi. Duke krijuar hapësira për prezantimin e krijimtarisë së tyre, synohet zhvillimi i skenës artistike lokale dhe nxitja e talenteve të reja.

5.1.5 Promovimi i trashëgimisë kulturore
Në fokus të këtij objektivi është ruajtja dhe promovimi i trashëgimisë materiale dhe shpirtërore të komunës së Kaçanikut. Përmes projekteve, ekspozitave dhe aktiviteteve edukative synohet valorizimi i monumenteve historike, zakoneve, traditave dhe trashëgimisë folklorike.

5.1.6 Festivalet, koncertet, shënimi i datave historike kulturore, simpoziumet dhe ekspozitat
Organizimi i këtyre aktiviteteve synon pasurimin e jetës kulturore në komunë dhe krijimin e një kalendari të qëndrueshëm kulturor. Këto ngjarje shërbejnë si platformë për prezantimin e vlerave artistike, përkujtimin e datave të rëndësishme historike-kulturore dhe nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve.

5.1.7 Përkrahja për grupet/shoqëritë kulturo-artistike dhe OJQ-të në komunën e Kaçanikut
Mbështetja do t'u ofrohet grupeve dhe shoqërive kulturo-artistike si dhe OJQ-ve aktive në fushën e kulturës, duke u bazuar në realizimin e suksesshëm të programeve të tyre në vitet paraprake dhe në planprogramin e punës për vitin 2026. Qëllimi është fuqizimi i kapaciteteve të tyre dhe vazhdimësia e aktiviteteve cilësore kulturore.

Afati i fundit për dorëzimin e propozimeve është **15 ditë pune** dhe përfundon me datë **25.02.2026.**

- OJQ-të mund të aplikojnë me 1 projekt në kuadër të kësaj thirrjeje ;
- Shuma minimale e mbështetjes financiare për OJQ-të që mund të alokohet për një projekt është **500 €**, ndërsa shuma maksimale është **20,000 €**;
- Periudha e zbatimit të projektit është deri në përfundimin e vitit **2026**;
- Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë OJQ-të që janë të regjistruara në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe që veprojnë në Komunën e Kaçanikut;
- OJQ-të aplikuese duhet të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushën e Rinisë dhe Sportit;
- OJQ-të duhet po ashtu të kenë kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente, sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje me rregullat e kontabilitetit;
- OJQ-të duhet të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare publike;
- Para nënshkrimit të kontratës, OJQ-ja duhet të paraqesë prova se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale, si dhe prova se OJQ-ja ka zgjidhur çdo çështje të hapur lidhur me pagesën e kontributeve dhe tatimeve të papaguara, nëse është e aplikueshme.

6.Propozimet do të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët, së bashku me **Udhëzimet për Aplikantët**, janë në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Kaçanikut:
☞ **http://kk.rks-gov.net/kacanik** (Kliko: **SHPALLJET – APLIKACIONET)**

7.Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: ✉ **lulzim.n.krasniqi@rks-gov.net**

Kërkesës së aplikimit duhet t'i bashkëngjiten edhe dokumentet:

- Certifikata e numrit të regjistrimit dhe numrit fiskal të organizatës;
- Vërtetim nga DKRS në Kaçanik për regjistrimin e OJQ-së dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktuale për vitin paraprak (vërtetim i lëshuar në vitin 2026);
- Letërnjoftimi i personit (aplikantit) që përfaqëson organizatën dhe i menaxherit të projektit;
- Xhirollogaria dhe dëshmia e bankës në emër të organizatës;
- Dëshmi se organizata nuk ka obligime ndaj ATK-së.

Dokumentacioni që shkarkohet nga ueb-faqja e Komunës së Kaçanikut:

1. Formulari i aplikacionit për projekt/program (Formulari **F9**);
2. Formulari i propozim-buxhetit (Formulari **F10**);
3. Formulari i deklaratës për mungesën e financimit të dyfishtë (Formulari **F11**);

4. Formulari i deklarimit të programeve apo projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike (Formulari **F13**);
5. Formulari i deklaratës së partneritetit, nëse është e aplikueshme (Formulari **F12**);
6. Deklaratë e aktiviteteve të kontraktorit të përmendura në përshkrimin e aktiviteteve të projektit, që janë të njohur me programin ose projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin e projektit, nëse është e aplikueshme (Formulari **F14**);
7. Dokumentacioni i aplikimit duhet të printohet, të nënshkruhet nga menaxheri i projektit dhe përfaqësuesi i OJQ-së dhe të vuloset. Ky dokumentacion i dorëzuar në tërësi skanohet dhe dorëzohet së bashku me të gjitha dokumentet përcjellëse në **CD ose USB (obligative)**.

Komuna e Kaçanikut do të formojë një komision profesional për vlerësimin e projekteve dhe rezultatet do të jenë publike për secilën OJQ aplikuese, të detajuara sipas Rregullores **MF-NR-04-2017** mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe Rregullores Komunale Nr. **06/2016** për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.

Data e aplikimit është nga **04.02.2026** deri më **25.02.2026**.

Dorëzimi i aplikacioneve:
Objekti i Komunës së Kaçanikut, Zyra Pritëse (Sporteli nr. 5).

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënies së fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve, si dhe kalendari tregues i zbatimit të ftesës janë të detajuara në **Udhëzimet për Aplikuesit** (ju lutemi konsultoni Udhëzuesin për aplikim I publikuar ne ëeb faqen e komunës). Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike dhe që i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të ftesës publike.

Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Lulzim Krasniqi – Drejtor

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA